



Datë: 03.12.2025
Numër Protokolli: 7711/2025

A.nr.1837/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Eshref Shabani, kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi, dhe Malsore Gashi-Bajraktari anëtarë, me Ilire Mehmeti-Shaqiri, në cilësinë e procesmbajtëses ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1837/2025 të datës 23.10.2025, të parashtruar nga ankuesi R.A, kundër organit të punësimit Sekretariati i Këshillit Gjyqësorë i Kosovës, në çështjen juridike “*masë disiplinore-vërejtje me shkrim*”, në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafin 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 03.12.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.1837/2025 të datës 23.10.2025 e parashtruar nga ankuesi R.A.

II. Shfuqizohet masa disiplinore “*vërejtje me shkrim*”, me numër ASHC.nr.16/2025 e datës 06.10.2025, nga Udhëheqësi i Zyrës për Mbështetje Juridike në Gjykatën Themelore në Gjilan.

III. Obligohet Udhëheqësja e Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Sekretariatën e Këshillit Gjyqësorë të Kosovës , për zbatimin e këtij vendimi në afat prej pesëmbëdhjete (15) ditësh nga dita e pranimit të tij, të bëjë zbatimin e këtij vendimi duke bërë shuarjen e masës disiplinore ndaj ankueses në pajtim me këtë vendim.

IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi.

A r s y e t i m

Nëpunësi civil, R.A (në tekstin e mëtejme referuar: ankuesi), më datë 23.10.2025, ka parashtruar ankesë me numër protokolli 6946/2025, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër “*vërejtjes me shkrim*”, të shqiptuar me date 06.10.2025, nga Udhëheqësi i Zyrës për Mbështetje Juridike në Gjykatën Themelore në Gjilan.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datën 30.10.2025 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën tek Sekretariati i Këshillit Gjyqësorë, ndërsa kjo e fundit, më datë 17.11.2025, ka përcjellë përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (*tutje referuar Kolegji i Këshillit*), ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 6946/2025 të datës 23.10.2025, të parashtruar nga ankuesi në Këshill; Vërejtjen me shkrim nen shenjen ASHC.nr.16/2025 të datës 06.10.2025 e Udhëheqësit të Zyrës për Mbështetje Juridike; Dokumentin e identifikimit të ankuesit; Raportin mjekësorë të lëshuar nga ordianca Olive me date 02.10.2025; Shkresën mjekësore të datës 02.10.2025; Deklaratën e datës 03.10.2025 të parashtruar nga ankuesi lidhur me arsyetimin e tij për shkak të mungesës në punë; Raportin mjekësore të datës 03.10.2025; Emalin e datës 13.10.2025; Kërkesën e datës 30.10.2025; Përgjigjen në ankesë me numër protokolli 17.11.2025; Akt emërimit me numër protokolli 03/1319 të datës 18.07.2025; Regjistrin mbi kontrollin e vijimit të punëtoreve në punë për datën 03.10.2025.

Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të dorëzuara nga palët në procedurë si dhe pretendimeve ankimore të ankuesit konstatoi se ankesa **është e bazuar**, sepse:

Nga administrimi i shkresave të lëndës rezulton se, ankuesi sipas Aktit emërimit me numër 03/1319 të datës 18.07.2025, është e punësuar në pozitën “Zyrtar Ligjor” në Sekretariati e Këshillit Gjyqësorë të Kosovës, gjykata Themelore në Gjilan. Tutje, nga shkresa e lëndës rrjedhë se, Udhëheqësi i Zyrës për Mbështetje Juridike, përmes e-mailit të datës 06.10.2025, i ka shqiptuar ankuesit masën disiplinore: “*vërejte me shkrim*”, për shkak të mungesës në punë (nga ora 08:00 deri në orën 13:00) me datë 03.11.2025 pa ndonjë njoftim paraprak.

Andaj, ankuesi kundër vërejtjes me shkrim të shqiptuar, me datë 06.10.2025 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, me pretendimin ankimor se me datë 03.10.2025 ka pasur përkeqësim shëndetësor dhe ka qenë në vizite mjekësore, ku si rrjedhojë me datë 02.10.2025 ka bërë analiza mjekësore ndërsa me datë 03.10.2025 nga ora 09:00 ka qenë në vizitë mjekësore, dhe pas përfundimit të vizitës është paraqitur në punë në orën 13:00 andaj i njëjti, kërkon nga Këshilli anulimin e vërejtjes.

Kolegji i Këshillit, me qëllim të shqyrtimit dhe vërtetimit të pretendimeve ankimore të ankuesit, i'u referua dispozitave të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht:

-nenit 55, i cili përcakton se: *1. Nëpunësja/i civil mban përgjegjësi disiplinore për shkelje të detyrave dhe përgjegjësi, në rastet kur nuk kryen detyrat që i janë dhënë, kur bën zbatim jo të duhur të tyre apo kur gjatë ushtrimit të tyre vepron në kundërshtim me Kushtetutën, ligjet dhe akte të tjera nënligjore në fuqi. Shkelja disiplinore mund të bëhet me veprim apo mosveprim.;*

-nenit 56 paragrafit 1, 2 dhe 3, ku përcaktohet se: *1. Shkeljet e detyrave dhe përgjegjësi të punës mund të jenë: 1.1. shkelje të lehta; 1.2. shkelje të rënda. 2. Shkeljet e rënda të detyrave dhe përgjegjësi të punës janë të përcaktuara me ligj, ndërsa shkeljet e lehta janë të përcaktuara me ligj dhe rregulla të brendshme. 3. Shkelje të lehta konsiderohen: 3.1. mungesa e paarsyeshme në punë deri në dy (2) ditë pune radhazi; 3.2. mosrespektimi i orarit të punës; 3.3. sjellja jo e mirë gjatë kohës së punës, me mbikëqyrëset/it, koleget/ët, vartëset/it dhe me publikun;*

-nenit 57 paragrafit 1, ku përcaktohet se: *1. Masat disiplinore, të cilat mund të shqiptohen ndaj nëpunës/it civil për shkelje të lehta janë: 1.1. vërejtje verbale; 1.2. paralajmërim me shkrim; 1.3. vërejtje me shkrim.;* si dhe,

-nenit 58 paragrafit 1, i cili përcakton se: *1. Masat disiplinore për shkeljet e lehta shqiptohen nga mbikëqyrësja/i i drejtpërdrejtë dhe/apo nga udhëheqësja/i më i lartë administrativ.*

Ndërlidhur me dispozitat e Rregullores (QRK) Nr.04/2024 për Orarin e Punës, Pushimet dhe Vijushmërinë e Zyrtarëve Publik, ku sipas,

-nenit 4, përcaktohet se: *Orari i punës nënkupton periudhën kohore, gjatë së cilës zyrtari publik kryen punë ose shërbime në të mirë të institucioni. 2. Orari i punës së zyrtarëve publik fillon në orën 08:00 dhe përfundon në orën 16:00, pesë (5) ditë në javë duke filluar nga e hëna deri të premten, përveç nëse caktohet ndryshe nga institucioni përkatës për shkak të natyrës së punës.....*

-nenit 11 përcaktohet se: *1. Zyrtari publik në rast të sëmundjes ka të drejtë për pushim mjekësor në kohëzgjatje deri njëzet (20) ditë punë brenda një (1) viti me kompensim 100% të pagës. 2. Zyrtari publik i cili e shfrytëzon pushimin mjekësor, duhet të informoj mbikëqyrësin e drejtpërdrejtë dhe të ofrojë dëshminë përkatëse nga organi kompetent mjekësor. 3. Ditët e parapara për pushim mjekësor zyrtari publik mund ti shfrytëzojë edhe në rast të sëmundjes së fëmijës së tij, me dëshmi të organit mjekësor. 4. Zyrtari publik ka të drejtë për kompensim të pushimit mjekësor si pasojë e lëndimit në punë, ose sëmundjes profesionale të ndërlidhur me kryerjen e punëve dhe të shërbimeve për institucionin, në kohëzgjatje prej dhjetë (10) deri në nëntëdhjetë (90) ditë pune me kompensim prej 70 % të pagës së tij. 5. Dëshmi nga organi kompetent mjekësor, sipas paragrafit 2 dhe 3 të këtij neni, nënkupton dëshminë e cila përcakton qartë ditët e mungesës në punë për shkak të gjendjes së tij mjekësore. 6. Pas kalimit të periudhës me kompensim, sipas paragrafit 1 dhe 3 të këtij neni, zyrtari publik me rekomandimin e organit kompetent mjekësor ka të drejtë të vazhdojë pushimin mjekësor pa pagesë. 7. Për kohën e mungesës në punë pa pagesë nga paragrafi 6 i këtij neni, të punësuarit i pushojnë të drejtat dhe detyrat nga marrëdhënia e punës, përveç të drejtës për kthim në vendin tij të punës.; si dhe sipas,*

-nenit 12, përcaktohet se: *1. Në rast të sëmundjes ose paaftësisë së përkohshme për punë, zyrtari publik është i obliguar të informojë mbikëqyrësin e drejtpërdrejt menjëherë ose më së largu gjatë ditës së mungesës nga puna. 2. Në rast të sëmundjes ose lëndimit serioz që i pamundëson zyrtarit publik që të informojë mbikëqyrësin e drejtpërdrejt sipas paragrafit 1 të këtij neni zyrtari publik duhet të bëjë përpjekje për të informuar mbikëqyrësin e drejtpërdrejt sa më shpejt që është e mundur. 3. Nëse zyrtari publik nuk dëshmon se ka bërë përpjekje të arsyeshme për të informuar mbikëqyrësin e drejtpërdrejt për mungesën e tij, për vonesa të paarsyeshme në njoftim, zyrtari publik konsiderohet se ka bërë shkelje të lehtë disiplinore. 4. Nëse mungesa e lajmëruar nga puna zgjat më shumë se tri (3) ditë, mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë ka të drejtë të kërkojë nga zyrtari publik certifikatën mjekësore që arsyeton mungesën nga puna. 5. Mungesa nga puna sipas përcaktimeve të këtij neni llogaritet në ditët e lejuara të pushimit mjekësor me pagesë.*

Kolegji i Këshillit, bazuar në kuadrin ligjor si më sipër dhe me qëllim të shqyrtimit dhe vërtetimit të pretendimeve ankimore të ankuesit, nga analizimi shkresave të tërësishme të lëndës dhe e-mailit të datës 06.10.2025, përmes së cilit Udhëheqësi i Zyrës për Mbështetje Juridike në Gjykatën Themelore në Prishtinë, i ka shqiptuar ankuesit masën disiplinore: *“vërejte me shkrim”*, si rrjedhojë konstaton se e njëjta shkresë, është e përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, respektivisht nenit 47 paragrafi 1 nen paragrafi 1.4 i cili përcakton se *1.4 pjesën përmbyllëse, që tregon kohën e hyrjes në fuqi të aktit, informatat për mjetet juridike, përfshirë organin publik apo gjykatën ku paraqitet mjeti juridik administrativ apo gjyqësor, formën e mjetit, afatin përkatës dhe mënyrën e llogaritjes së tij (këshillën juridike). Në rast kur ushtrimi i ankesës administrative, sipas ligjit, nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ, pjesa përmbyllëse gjithashtu duhet të përmbajë këtë informacion, si dhe bazën ligjore për një përjashtim të tillë.*

Tutje, Kolegji i Këshillit, konstaton se ankuesit masa disiplinore “*vërejte me shkrim*”, për shkak të mungesës në punë me datë 03.10.2025 nga ora 08:00 deri ne orën 13:00 pa ndonjë njoftim paraprak, i është shqiptuar me date 06.10.2025, ndërsa nga shkresat e lëndës, rezulton se ankuesi ka parashtrua Deklaratën me të cilën ka sqaruar mungesën në punë për shkaqe shëndetësore, po ashtu ka përcjell shenjat mjekësore ku qartë shihet data 03.10.2025 dhe ora 10:38 në raportin mjekësore, andaj rrjedhë se i njëjti ka vepruar në pajtim me nenin 12 paragrafin 1 të Rregullores (QRK) Nr.04/2024 për Orarin e Punës, Pushimet dhe Vijueshmërinë e Zyrtarëve Publik, i cili përcakton *Në rast të sëmundjes ose paaftësisë së përkohshme për punë, zyrtari publik është i obliguar të informojë mbikëqyrësin e drejtpërdrejt menjëherë ose më së largu gjatë ditës së mungesës nga puna.*

Andaj, theksuar si më sipër, Kolegji i Këshillit konstaton se masa disiplinore: “*Vërejtje me shkrim*” e shqiptuar ndaj ankuesit, përmes e-mailit të datës 06.10.2025 nga Udhëheqësi i Zyrës për Mbështetje Juridike në Gjykatën Themelore ne Gjilan, është në nxjerrë përmes shkeljeve të ligjit material dhe vërtetimit jo të plotë të gjendjes faktike, gjegjësisht në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, Rregullores (QRK) Nr.01/2024 për Disiplinën e Nëpunësve Civil si dhe dispozitave të Rregullores (QRK) Nr.04/2024 për Orarin e Punës, Pushimet dhe Vijueshmërinë e Zyrtarëve Publik, dhe se e njëjta masë është e paligjshme në kuptim të dispozitave të Ligjit Nr.05/l - 031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përkatësisht nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 ku përcaktohet se: 1. Një akt administrativ është i paligjshëm nëse: *1.4. është nxjerre në kundërshtim me dispozitat që rregullojnë formën apo elementet e detyrueshme të aktit administrativ.*

Kështu që, për sa me sipër dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 si dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1837/2025

Ilire Mehmeti-Shaqiri

Procesmbajtës

Eshref Shabani

Kryetar Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit R.A;
- Udhëheqëses së Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Sekretariatit Gjyqësor të Kosovës; si dhe,
- Arkivit të KPMSHCK-së.